

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“IN OUT STUDIO” sh.p.k.**

Sot, me date 02 Shkurt 2022, une i neneshkruari:

- Z. Matteo Gennari, Shtetas Italian, lindur ne Magenta (MI) Itali me 18.09.1979 me atesi Z. Enrico, banues ne “343 Route de la Turbie 06360 Eze France”, mbajtes i dokumentit te identitetit me numer: YA7764723, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Ne perputhje me Ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008, “Per tregetaret dhe Shoqerite Tregetare” (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723 date 3.5.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit” (i ndryshuar) kam vendosur te themeloj nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar te emeruar “IN OUT STUDIO” sh.p.k (me poshte referuar si “Shoqeria”), duke neneshkruar kete Akt Themelimi, Aktiviteti i kesaj Shoqerie do te rregullohet nga Statuti i saj, i cili eshte pjese perberese e ketij Akti Themelimi.

Neni 1

Emri i Shoqerise eshte “IN OUT STUDIO” sh.p.k.

Neni 2

Selia e Shoqerise ndodhet ne Adresen: “Rr. Stefan Shundi, Zone Kadastrale 3866, Nr. Pas. 214/321+1-3, Yzberisht, Kashar, Tirane”.

Shoqeria ka te drejte te hape dege dhe filiale, zyra perfaqesimi, ne te gjitha vendin, brenda ose jashte territorit te vendit, gjate aktivitetit te saj.

Neni 3

Kohezgjatja e aktivitetit te Shoqerise do te jete e pakufizuar, duke filluar qe prej dates se regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznesit (QKB).

Neni 4

Objekti i veprimtarise se Shoqerise eshte si vijon:

- Aktivitet në fushën e arkitekturës, funksionimi i një zyre arkitekurore dhe të gjitha aktivitetet e lidhura me arkitekturën dhe ndërtimin, veçanërisht: Konceptimi, planifikimi, ekzekutimi i arkitekturës dhe modelimit të brendshëm e të jashtëm, planifikimit urban, planifikimit local dhe rajonal, ndërtim dhe revizim.

- Konsulencë në fushën e arkitekturës, vlerësime, analiza ndërtesash, vlerësime të çmimeve të tregut. Ekspertiza në këtë fushë.

- Aplikim për leje zhvillimi për ndertime si dhe artit në ndërtim.


- Mbikqyrje profesionale e projektit të ndërtimit, ndjekje punimesh sipas projektit.

- Projektim: godina biznesesh, hotelesh, komplekseve turistike, rezidenciale, interior design, arredim urban e gjelbërim, objekte sportive, salla sporti, ambiente rekreative, interiori për zyra, dyqane, apartamente.

- Studio për asistencë dhe konsulencë në projekte ndërtimi, studio projektimi për kapanone industriale.

- Vlerësim i raporteve mjedisore. Konsulencë inxhinierike. Konsulencë ligjore për leje zhvillimore. Planifikim dhe projektim urban. Projekte arkitektonike. Projekte konstruksioni. Projekte mekanike. Projekte elektrike. Projekte interieri. Rilevime topografike. Projektim-zbatim-ndërtim të objekteve civile, industriale, bujqësore, blegtorale, ushtarake, turistike, kulturore, prodhime të ndryshme betoni armatura të ndryshme, punime restaurimi, rrugë, kanalizime, hidrosanitare, ujësjellës, objekte social-kulturore, objekte të tjera, si shkolla etj.

- Kryerje e studimeve dhe planifikimeve dhe arkitekturën e peisazheve, projekte për kopshte dhe parqe etj. Në veçanti prodhimi dhe vizualizimi 3D; Ekspertizë dhe këshilla, punë në fushën e ruajtjes së monumenteve, studime fizibiliteti, aplikime ndërtimi, matje gjeometrike, ndërtime urbane, projekte si brenda dhe jashtë vendit.



Konsulencë, dhënie të këshillave ndërtimore për ndërtuesit, vizatim dhe hartim/dizajn të planeve të ndërtesave, mbikëqyrje të punimeve ndërtimore. Dixhitalizimi i planeve të inventarit; këshilla artistike dhe edukim arti; tregtia në art; blerja, shfrytëzimi, marrja me qira, qiradhënia e produkteve të artit (piktura, skulptura, art në ndërtim) etj.

- Produkte artizanale, tregti, import, eksport dhe tregtim me shumicë dhe pakicë të të gjithë llojeve të mallrave e materialeve të ndërtimit të përfunduara dhe të pa përfunduara, objekteve të ndërtimit, materialeve hidrosanitare, transport për vete dhe për të tretët

- Shitja dhe blerja, dhenja me qira dhe menaxhimin e pasurive të patundshme në përgjithësi.

- Për sa kohë që konsiderohet e nevojshme ose e dobishme nga organet drejtuese për arritjen e qëllimit të biznesit, shoqëria mund të kryejnë operacione të letrave me vlerë, pasurive të patundshme, tregtare, industriale, leasing si përdorues, si një autor i factoringut, operacione financiare të cdo lloji.

- Dhenien e garancive financiare çdo personi fizik ose juridik, kompani, institucion, linjave të kreditit kombëtare ose të huaj dhe paradhënies bankare, overdrafte bankare, ndihma hipotekare dhe në përgjithësi çdo transaksion financiar dhe sigurimi, si dhe dhënie e garancive hipotekore dhe cdo lloj garancie në favor të palëve të treta.

- Ajo gjithashtu mund të marrë pjesë në investime të qëndrueshme në shoqëri në shoqëri ekzistuese, të cilat kanë aktivitete të njëjta ose të përafërta me objektin e shoqërisë të percaktuar në këtë statut.

- Si dhe cdo aktivitet tjetër i cili është i nevojshëm për arritjen e qëllimeve të sipërpermendura të shoqërisë.

Neni 5

Kapitali fillestar i Shoqërisë është 500 € e barazvlefshme me 60 500 (gjashtedhjetë mijë e pesëqind) leke dhe i ndarë në 1 pjesë (kuota) me vlerë nominale 60 500 (gjashtedhjetë mijë e pesëqind) leke.

Kapitali zotërohet nga ortakut i shoqërisë si më poshtë:

-Z. Matteo Gennari, i cili zotëron 1 kuota të Shoqërisë ose 60 500 (gjashtedhjetë mijë e pesëqind) leke që përfaqësojnë 100 % të kapitalit të Shoqërisë.

Ortakut i Shoqërisë mund të vendosë të rrisë kapitalin e Shoqërisë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë. Detyrimet e ortakut të shoqërisë kundrejt Shoqërisë do të mbulohet vetëm me pjesën e kapitalit të paguar prej tij.

Neni 6

Shoqëria vepron nën rregjimin e pronës private dhe merr përsipër vetes të drejtat dhe detyrimet kontraktore dhe jashtëkontraktore.

Shoqëria është e organizuar në organet e mëposhtme:

-Asambleja e Përgjithshme;

-Administratori;

Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme si dhe të administratorit të Shoqërisë janë të parashkruara në Statutin e Shoqërisë.

Neni 7

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet të bëhet publike përmbajtja e tyre për të tretët, e të gjitha akteve dhe dokumenteve që janë percaktuar si të tilla nga administratori i shoqërisë.

Neni 8

Mardheniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës së punës dhe legjislativës së punës në fuqi. Shoqëria merr përsipër të respektojë rregullat në fuqi të punësimit dhe të punësuarit janë të detyruar që ta respektojnë Statutin e kësaj Shoqërie dhe rregullat e brendshme të saj. Te punësuarit duhet të përgjigjen për demot që shkaktojnë kësaj Shoqërie me veprimet dhe mosveprimet e tyre.

Neni 9



Ne rast se Shoqeria do te mbyll aktivitetin e saj per cdo lloj arsye, Asambleja e Jashtezakonshme e Ortakeve te Shoqerise, percakton menyren e likuidimit, emerone nje ose me teper likuidatore dhe pergatit te gjitha dokumentet e nevojshme per c' regjistrimin e saj nga Qendra Kombetare e Biznesit.

Neni 10

Kontrolli mbi veprimtarine e Shoqerise si dhe gjithe aktivitetin e Shoqerise i besohet nje eksperti kontabel. Ky ekspert do te emerohet dhe qendroje ne detyre sipas parashikimeve qe ben ligji per ekspertet dhe mund te rizgjidhet. Asambleja e Pergjithshme cakton edhe shperblimin perkates kur nuk ka norma te vecanta ligjore.

Neni 11

Viti financiar fillon ne 1 Janar dhe mbaron ne 31 dhjetor te secilit vit. Perjashtim, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise prane Qendres Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 dhjetor. Administratori merr masat me qellim hartimin e bilanceve, rezultateve ekonomike te fitimeve apo humbjeve dhe inventarizimin. Pas analizimit te ceshtjeve te mesiperme si dhe shlyerjen e detyrimeve, te ardhurat e tjera do ti kalojne ortakeve te Shoqerise.

Neni 12

Akti i Themelimit eshte hartuar ne 4 kopje origjinale ne gjuhen shqipe. Per sa eshte shprehur ne kete Akt Themelimi, i referohemi ligjit 9901, date 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" (i ndryshuar).

ORTAKU I VETEM
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"IN OUT STUDIO" sh.p.k.

(*MATEO GENIAR*)

Emer Mbiemer Nenshkrimi

ADMINISTRATORI

Altin Wala

A.